



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PËRMBARIMIT
DREJTORIA E SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

Nr. 730/prot.

Tiranë, më 18.05.2026

**NJOFTIM PËR POZICIONIN VAKANT "PËRGJEGJËS, SEKTORI I
BUXHETIT, FINANCËS DHE SHËRBIMEVE" NË ZYRËN PËRMBARIMORE
GJYQËSORE TIRANË.**

Në mbështetje të Ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 "*Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë*" i ndryshuar, Ligjit nr. 8 /2023 "*Për Organizimin dhe Funksionimin e Shërbimit Përmbartimor Gjyqësor Shtetëror*", Urdhërit të Kryeministrit Nr. 117, datë 26.08.2025 "*Për disa ndryshime në Urdhërin nr.222, datë 14.12.2023 të Kryeministrit, "Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Shërbimit Përmbartimor Gjyqësor Shtetëror", si dhe Udhërit Nr.128, datë 14.10.2025 "Për miratimin e metodologjisë së vlerësimit të kandidatëve punonjës pranë Shërbimit Përmbartimor Gjyqësor Shtetëror". Drejtoria e Përgjithshme e Përmbartimit shpall në faqen zyrtare të DPP njoftimin për personat e interesuar për pozicionin:*

**1 (një) Përgjegjës, Sektori i Buxhetit, Financës dhe Shërbimeve, Zyra Përmbartimore
Gjyqësore Vendore Tiranë.**

- **Kategoria e pagës:** Klasa III-3 (sipas VKM nr. 325, datë 31.05.2023, i ndryshuar)
- **Lloji i punës:** Punë me kohë të plotë (8 orë në ditë, me afat të caktuar)

Detyrat kryesore:

1. Përgjegjësi i sektorit është nëpunës i nivelit të ulët drejtues, përgjegjës për mbarëvajtjen dhe koordinimin e punës në sektorin përkatës.
2. Përgjegjësi i sektorit bashkërendon punën brenda sektorit me specialistët në varësi të tij dhe përgjigjet për:
 - a) realizimin e detyrave të ngarkuara nga kuadrin rregullator në fuqi ose nga eprori përkatës, brenda afatit dhe raportimin mbi to;
 - b) ligjshmërinë e veprimtarisë së sektorit;
 - c) ndarjen e drejtë dhe proporcionale të detyrave;

ç) kryen çdo detyrë tjetër që i ngarkohet nga eprori dhe që parashikohet në rregulloren e Drejtorisë së Përgjithshme të Përmbarimit.

I. Kushtet që duhet të plotësojnë kandidati:

1. Të jenë shtetas shqiptar;
2. Të kenë zotësi të plotë për të vepruar;
3. Të zotërojnë gjuhën shqipe në të folur dhe të shkruar;
4. Të jenë në kushtet shëndetësore që lejojnë kryerjen e detyrave përkatëse;
5. Të mos jenë të dënuar me vendim të formës së prerë;
6. Të kenë zotërojnë minimalisht diplomën “Master i Shkencave” në Arsimin të Lartë, ose e barasvlefshme me të në fushën e shkencave ekonomike, dega Finance-Kontabilitet.
7. Të ketë përvojë pune mbi 3 (tre) vjeçare në fushën ekonomike, financiare dhe menaxheriale.
8. Të kenë aftësi të mira komunikuese.
9. Të respektojnë etikën dhe komunikimin me qytetarët që drejtohen pranë institucionit;
10. Të mos ketë masë disiplinore në fuqi ose të mos jetë larguar me masë disiplinore “Shkarkim nga detyra” që nuk është shuar sipas ligjit nr.7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës Republikës së Shqipërisë”.

II. Dokumentacioni, mënyra dhe afati i dorëzimit:

1. Kërkesë për aplikim për pozicionin;
2. Curriculum Vitae
3. Fotokopje e noterizuar e diplomës (përfshirë edhe diplomën bachelor). Për diplomat e marra jashtë Republikës së Shqipërisë të përcillet njësimi nga Ministria e Arsimit dhe Sporteve).
4. Çdo dokument tjetër që vërteton mesataren e ponderuar të diplomës, listë notash, trajnime , kualifikime , vlerësime pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj
5. Fotokopje e noterizuar e librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën e punës).
6. Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
7. Vërtetim të gjendjes shëndetësore;



8. Vërtetim i gjendjes gjyqësore.

9. Vërtetim nga Prokuroria e Rrethit, që nuk ka çështje penale në ngarkim

10. Vërtetim nga Gjykata e Rrethit, që nuk ka çështje penale në ngarkim

11. Vërtetim për detyrimet përmbartimore

REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PRAPRAK.

Në datën **26.05.2026**, Drejtoria e Përgjithshme e Përmbartimit do të njoftojë elektronikisht të gjithë kandidatët që plotësojnë kushtet dhe kriteret për kualifikim, si dhe do të njoftojë datën, orën dhe vendin e saktë ku do të zhvillohet provimi me shkrim si dhe intervista. Si dhe në të njëjtën datë do të njoftohen edhe kandidatët që nuk plotësojnë kriteret e pranimit në mënyrë elektronike për shkak të moskualifikimit.

FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET TESTIMI DHE INTERVISTA.

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

- Njohuritë mbi ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”
- Njohuritë mbi ligjin nr.9936, datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”
- Njohuritë mbi ligjin nr.8, datë 02.02.2023 “Për Organizimin dhe Funksonimin e Shërbimit Përmbartimor Gjyqësor Shtetëror”
- Njohuritë mbi ligjin Nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë”
- Njohuritë mbi ligjin nr.9154, datë 6.11.2003 “Për Arkivat” (Ndryshuar me Ligjin nr. 27/2024, datë 4.4.2024.

Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:

- a) Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin përgjithësues të punës.
- b) Eksperiencën e tyre të mëparshme.
- c) Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.

DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT.

Metodologjia e vlerësimit është e publikuar në faqen zyrtare të Drejtorisë së Përgjithshme të Përmbartimit. Në përfundim të procedurës së vlerësimit, Drejtoria e Përgjithshme do të shpallë fituesin në faqen zyrtare. Të gjithë kandidatët do të njoftohen mbi rezultatet në adresën e tyre elektronike.

Dokumentat duhet të dorëzohen dorazi ose nëpërmjet postës zyrtare në Drejtorinë e Përgjithshme të Përmbarimit me adresë sheshi. "Mustafa Qemal Atatürk", Njësia Administrative nr. 7, kryqëzimi 21 dhjetorit, Tiranë, deri në datën 25.05.2026.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

